



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000069/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisarjatin e Policisë "Nënë Tereza" Rinas .

Drejtuar : **Z. Përparim DEMA**
Shef i Komisarjatit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Rinas

TIRANË

Znj. Enkeleda TOSKA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Tiranë

TIRANË

Për dijeni: **Drejtues i Lartë Eduart MERKAJ**
Drejtor i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisarjatin e Policisë Kufitare dhe Migracionit "Nënë Tereza" Rinas .

Inspektimi u krye në datën 27.12.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe znj.Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të të drejtave të qytetarëve shqiptar dhe të huaj që hyjnë e dalin në Aeroportin "Nënë Tereza" Rinas, të personave të riatdhesuar nga policitë e vendeve të tjera, monitorimin e sjelljes së punonjësve të policisë me qytetarët dhe të kushteve të qëndrimit të tyre, referuar standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925 datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës

¹ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit në mungesë të shefit të Komisarariatit, u takua me shefin e kufirit z.Rigels Shahini, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në takimin me grupin e inspektimit, shefi i kufirit informoi mbi masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit të shtetasve, sipas kërkesave dhe procedurave standarde të përcaktuara në “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Gjithashtu, shefi i kufirit bëri me dije grupin e inspektimit se, shoqëria konçesionare “Tirana International Airport - shpk”, Rinas, në kuadër të investimeve që do të kryejë në këtë aeroport, është angazhuar që prej vitit 2018 të ndërtojë edhe një godinë me ambiente pune të reja për këtë komisarariat, por ky projekt ende nuk është realizuar. Në këto kushte, shërbimet për shtetasit shqiptarë dhe të huaj që ofrojnë punonjësit e policisë të këtij komisaritati, vazhdonin të kryheshin në ambientet ekzistuese.

Në vijim, grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë kufitare, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Shefi i kufirit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi i inspektimit në ambientet e këtij Komisaritati. Vlen të theksohet se ky bashkëpunim me institucionin tonë, duhet të shtrihet edhe në hetimin e rasteve individuale, për të garantuar zbatimin e ligjit në përputhje me standarde më të larta të të drejtave të njeriut.

Nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se kushtet në ambientin e shoqërimit të shtetasve shqiptar dhe të huaj, që hyjnë e dalin në Aeroportin “Nënë Tereza” Rinas, nuk kishin ndryshuar krahasuar me situatën e evidentuar në inspektimin e mëparshëm. Po ashtu, edhe ambienti ku qëndrojnë personat e riatdhesuar nga policitë e shteteve të tjera, ishte larg standardeve të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore dhe dokumentet ndërkombëtare, në të cilat parashikohen të drejtat që duhet të gëzojnë këta qytetarë.

Sipas informacionit të drejtuesve të komisarariatit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, rezultoi se, rekomandimet nuk

ishin zbatuar për arsye të mungesës të investimeve për ndërtimin e godinës të re të këtij Komisariati, por edhe për mungesën e fondeve buxhetore, për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e ambienteve ekzistuese. Më konkretisht:

- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për shtimin në ambientin e shoqërimit të 2 dhomave të tjera, për mbajtjen dhe trajtimin e personave të shoqëruar, sipas kritereve të përcaktuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”;
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për ndërtimin ose krijimin e ambienteve të përshtatshme, me hapësirën e duhur, me ndriçim natyral, me ajrim dhe të pajisura me orenditë e nevojshme me qëllim për të siguruar kushte normale për qëndrimin dhe akomodimin e qytetarëve të riatdhesuar nga vendet e tjera.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për të mundësuar ndërtimin e ambienteve të nevojshme pune dhe me kushte e standarde bashkëkohore, për punonjësit e policisë të këtij komisariati që zhvillojnë procedurat e riatdhesimit.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në koridorin dhe në ambientet e tjera të shoqërimit të këtij Komisariati.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e zyrës ku merren në pyetje/intervistohen shtetasit e shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këtë zyrë.

Këto probleme në infrastrukturë, janë veçanërisht të rëndësishme pasi në këtë komisarjat trajtohen një numër i madh personash, duke konsideruar numrin e lartë të operacioneve të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe jo vetëm.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisarjatin e Policisë së Kufirit dhe Migracionit “Nënë Tereza” Rinas, në tërësi nuk ishte ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Në këto dokumente përcaktohet se, personat e shoqëruar mbahen në ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar dhe *“Mjediset duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme për qëndrimin e personave..... të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur”*².

Komisariati i Policisë Kufitare kishte vetëm një dhomë për shoqërimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në konflikt me ligjin, e cila ndodhej në katin e parë të godinës kryesore, brenda territorit të këtij institucioni. Dhoma ishte e bollshme për qëndrim, me dritare e cila lejonte ajrim dhe ndriçim natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ajo ishte e pastër, por ishte e palyer. Ajo ishte e pajisur me karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Në ambientin dhe dhomën e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje

² Kreu VI, pika 3 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

qëndror apo pajisje elektrike. Në korridorin e katit të parë të godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte vetëm një tualet, i cili përdorej nga personeli komisarariatit dhe nga personat e shoqëruar.

Ambienti i shoqërimit nuk kishte zyrë më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e të shoqëruarve, e pajisur me orendi e nevojshme për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si tavolina pune, apo karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde, ato duhet të jenë të fiksuara në dysHEME në mënyrë të pa lëvizshme. Aktualisht, procedura e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar, kryhet në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Ambienti i shoqërimit nuk ruhej dhe nuk vëzhgohej me sistemin e kamerave.

Ambientet e qëndrimit të shtetasve të riatdhesuar

Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit, Rinas, ka për detyrë edhe kryerjen e procedurave me shtetasit shqiptarë të deportuar, të cilët riatdhesohen në mënyrë periodike nga shtetet e tjera. Ky ambient ndodhet në ndërtesë më vete, pranë godinës kryesore të Komisarariatit.

Ambienti përbëhej nga 2(dy) dhoma për qëndrimin ulur të shtetasve, të ndara për femra dhe të mitur në një dhomë dhe personat e rritur në dhomën tjetër. Ngjitur me këto dhoma, ndodhej dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin dhe marrjen e shenjave të gishtave të personave të deportuar. Kapaciteti i këtyre dhomave ishte për mbajtjen dhe qëndrimin ulur të rreth 30 persona, deri në pritje të përfundimit të procedurave.

Dhomat ku qëndronin shtetasit e deportuar, kishin një sipërfaqe rreth 25 m² dhe ishin të pajisura me karrige për të qëndruar ulur të shtetasve. Ngjitur me dhomat ndodhej dhe një tualet. Ato kishin ndriçim natyral dhe artificial nëpërmjet energjisë elektrike, por dritaret ishin të fiksuara dhe nuk hapeshin. Në tërësinë e tij, ky ambient nuk ishte i përshtatshëm për mbajtje shtetasit e riatdhesuar, referuar hapësirës, numrit të vogël të karrigeve dhe mungesës së ajrimit.

Personat e riatdhesuar regjistroheshin në librin përkatës dhe intervistoheshin nga punonjësit e policisë të këtij Komisarariatit. Ndërkohë, në dhomën e dedikuar ju merreshin shenjat e gishtave dhe kryheshin verifikimet nëpërmjet organeve të policisë sipas vendbanimit përkatës. Koha e qëndrimit në komisarariat të këtyre personave shkonte deri në 4 orë.

Dhoma e cila shërbente për akomodimin e femrave ashtu dhe për familjarët e riatdhesuar, i cili ishte i pajisur me dy divanë për qëndrimin ulur, si dhe një tualet brenda saj.

Ambientet e qëndrimit të shtetasve të deportuar në këtë godinë, ishin të pajisura me kamera dhe monitoroheshin për 24 orë.

Nga inspektimi i ambienteve të punës së punonjësve të policisë, u konstatua se ato ishin të kufizuara dhe jo komode për të kryer me efikasitet detyrat e tyre ligjore.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kufitare “Nënë Tereza” Rinas nuk kishte ambiente të sigurisë për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar dhe dënuarve me vendim të formës së prerë. Në momentin që këta persona identifikoheshin nga punonjësit e policisë kufitare, drejtuesit e komisarlatit bënë njoftimin dhe kryenin menjëherë transferimin e tyre për në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë apo për në ambientet e dhomave të sigurisë të drejtorive/komisariateve vendore të tjerë të policisë.

Sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët

Gjatë kohës së inspektimit në këtë komisarlat u monitorua edhe sjellja e punonjësve të policisë gjatë komunikimit me qytetarët e ndryshëm, si shtetasit shqiptarë të riatdhesuar nga vendet e tjera, ashtu edhe me qytetarët shtetas shqiptarë dhe të huaj që hynin e dilnin në Aeroportin “Nënë Tereza” Rinas. Nga monitorimi dhe pyetja e disa prej qytetarëve që hynin dhe dilnin nga aeroporti u konstatua se, punonjësit e policisë komunikonin në mënyrë korrekte dhe me etikë me ta, duke i trajtuar me respekt e dinjitet.

Gjatë inspektimit në këtë Komisarlat, grupi i inspektimit, nuk gjeti shtetas të saporiatdhesuar, që mund të intervistonte në lidhje me procedurat e ndjekura ndaj tyre nga punonjësit e policisë të këtij komisarlati. Por, nga informacioni i shefit të kufirit, u informuam se këtyre personave në momentin e dorëzimit të pasaportës dhe sendeve personale, ju jepej dhe një kopje e proces-verbalit të mbajtur nga punonjësi i policisë për secilin person të rikthyer. Aty pasqyrohen shkaqet e kthimit dhe kohëzgjatja e penaliteteve, si rezultat i shkeljeve të rregullave Shengen nga personi i kthyer konform nenit 109/1/f dhe 109/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”³.

Gjatë vitit 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të operacioneve për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë të organizuar nga FRONTEX në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka marrë pjesë me përfaqësues të saj në 26 operacione, duke dhënë kontributin në respektimin e standardeve më të larta të drejtave të këtyre shtetasve.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i tyre.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kufitare “Nënë Tereza” Rinas, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” nuk ishte i tipit “Model nr.1”, sikurse përcaktohet procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në zyrën e informacionit, punonjësi i shërbimit kishte një regjistër ku hidheshin të dhënat për personat e shoqëruar, i cili nuk ishte sipas “Model nr.1” të lartpërmendur. Ky regjistër përmbante disa nga rubrikat kryesore dhe ishte i sekretuar.

³ Neni 109/1/f “Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:
f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

Neni 109/ 5 “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë

Në zyrën e informacionit të Komisarariatit, kishte dhe një regjistër për evidentimin e të dhënave për personat e ndaluar/arrestuar apo të dënuarve me vendim të formës së prerë. Në këtë regjistër, evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, ora e ndalimit, ora e njoftimit të drejtorisë/komisariatit vendor të policisë që ka shpallur në kërkim, si dhe ora e transferimit të këtyre personave nga ky Komisarariat. Regjistri ishte i sekretuar.

Ndërkohë, u konstatua se në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk kishte asnjë ankesë apo kërkesë, të regjistruar.

Ambientet e intervistimit

Në Komisariatin e Policisë “Nënë Tereza” Rinas oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore. Ndërsa, ambientet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e riatdhesuar, ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.⁴

Nga monitorimi që u bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

⁴ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur personat e shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar në moshë madhore, të cilët kërkojnë ndihmë juridike nga avokat mbrojtës dhe nuk kanë mundësi financiare për të marrë këtë shërbim, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur personat e deportuar ishin të mitur në konflikt me ligjin, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Ndërkohë, u konstatua se në këtë Komisariat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, lidhur me plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin ambientit të shoqërimit dhe brenda në dhomën e shoqërimit të këtij Komisariati, nuk ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambientit të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionit në Rinas, sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhërit nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, duke krijuar mjedise të përshtatshme dhe dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin ulur të personave.
2. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin ose krijimin e ambienteve të përshtatshme, për qëndrimin dhe akomodimin e qytetarëve të deportuar nga vendet e tjera, të cilat të jenë me hapësirën e duhur, me ndriçim natyral, me ajrim dhe të pajisura me orënditë e nevojshme, me qëllim sigurimin e kushteve normale për qëndrimin ulur dhe trajtimin njerëzor e human të tyre.
3. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin dhe në dhomën e shoqërimit të këtij Komisariati.

4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të përshtatëshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë të hetimit, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen në zyrën e informacionit të regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, sipas “Model nr.1”, të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin në ambjentin e shoqërimit dhe ambjentin ku mbahen shtetasit e riatdhesuar, të posterave me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në mjediset e policisë, të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të riatdhesuar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA